



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 63, paragrafit 8, nenit 65, paragrafit 8 dhe nenit 66, paragrafit 8 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë (LZP), si dhe nenit 66, paragrafit 2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, më 29.01.2024, miraton këtë:

RREGULLORE E BRENDSHME NR.09/2024
PËR TRANSFERIMIN E NËPUNËSVE CIVILË NË KQZ

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për transferimin e përkohshëm, përhershëm dhe transferimin në rast ristrukturimit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen nga KQZ gjatë transferimin e përkohshëm, përhershëm dhe transferimin në rast ristrukturimit.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregullore, shprehjet kanë kuptimin e përcaktuar me LZP.

Neni 4

Transferimi i përkohshëm

1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rasteve të përcaktuara në nenin 63, paragrafin 1 të LZP.
2. Transferimi i përkohshëm, në rastet e parashikuara në Nenin 63, paragrafin 1, nenparagrafi 1.1 dhe 1.2 të LZP, nuk mund të bëhet për nëpunësit civilë në periudhën provuese.
3. Në kuptim të Nenit 63, paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të LZP, në periudhën dy (2) vjeçare të viteve të punës nuk llogaritet koha e periudhës provuese.
4. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 63. paragrafi 3 të LZP.
5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme.
6. Transferimi i përkohshëm mund të bëhet:
 - 6.1. Brenda KQZ, duke përfshirë edhe zyret e saj lokale;
 - 6.2. në një institucion tjetër, që punëson shërbyes civil, me marrëveshjen në mes KQZ dhe titullarit ku bëhet transferi i përkohshëm.

Neni 5

Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit

1. Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të KQZ, ose sipas kërkesës së një institucioni që ka të punësuar nëpunës civil. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër që ka të punësuar nëpunës civil, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm, duhet të marrë paraprakisht miratimin e KQZ.
2. Transferimi i përkohshëm në interes të KQZ, propozohet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) dhe miratohet nga Drejtori i Sekretariatit të KQZ (DSKQZ). NJMBNJ njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet.
 - 2.1. Për propozimin e transferit të përkohshëm në interes të institucionit, NJMBNJ mbështetet në analizën e plotësisht të kriterëve të pozitës të punës nga ana e nëpunësit ku ai kërkohet të transferohet.
3. Kur është e nevojshme, KQZ mund të kërkojë transferimin e përkohshëm të nëpunësve civil nga institucionet e tjera, që kanë të punësuar nëpunës civil. Pas pëlqimit reciprok, transferimi i përkohshëm i nëpunësit civil nga një institucion tjetër i shërbimit civil, bëhet në pajtim me

marrëveshjen në mes të KQZ dhe institucionit ku është kërkuar transferimi i përkohshëm i nëpunësit civil.

4. Nëpunësi civil, gjithashtu, mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar.

Neni 6

Transferimi për përmirësimin e rezultateve të punës

1. Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij, në bazë të planeve vjetore për përmirësim të rezultateve në punë brenda institucionit dhe institucioneve që kanë të punësuar nëpunës civil.

2. Transferimi bëhet me kërkesë të nëpunësit ose të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, e cila miratohet DSKQZ.

3. Plani vjetor për përmirësim të rezultateve në punë, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, është plani i transferimeve të përkohshme në rast të nevojës së KQZ ose nëpunësit civil për përmirësimin e rezultateve në punë.

Neni 7

Transferimi i përkohshëm për arsye shëndetësore

1. Transferimi i përkohshëm për arsye shëndetësore bëhet me kërkesë të nëpunësit civil, DSKQZ-së, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme dhe specifike të punës për a nëpunësin civil.

2. Kërkesa për transferim të përkohshëm, sipas paragrafit 1 të këtij neni, miratohet nga DSKQZ.

3. Transferimi i përkohshëm, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, është i mundshëm vetëm me vendim të komisionit kompetent mjekësor, në të cilin caktohet edhe koha e nevojshme për transferim të përkohshëm.

4. Transferimi i përkohshëm për arsye shëndetësore, nuk mund të bëhet pa pëlqimin e nëpunësit civil.

5. Nëpunësi civil i transferuar përkohësisht për arsye shëndetësore gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara me Ligj.

Neni 8

Refuzimi i transferit të përkohshëm

Refuzimi i transferit të përkohshëm mund të bëhet nga nëpunësi civil, vetëm për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 63 të LZP.

Neni 9

Paga dhe kompensimet gjatë transferimit të përkohshëm

1. Gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil përfiton pagën me komponentët e saj më të lartë ndërmjet pagës së pozitës të mëparshme dhe asaj në të cilën është transferuar.
2. Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i rregullt i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin.

Neni 10

Transferimi i përhershëm

1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të shërbimit civil, në rastet:
 - 1.1. E pa aftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme;
 - 1.2. e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj;
 - 1.3. të përfundimit të pezullimit, me kërkesë të nëpunësit civil, kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës;
 - 1.4. të shqiptimit të transferimit, si masë e pamjaftueshmërisë profesionale;
 - 1.5. të shqiptimit të transferimit, si masë disiplinore;
 - 1.6. transferimi i përhershëm, për interes të institucionit.

Neni 11

Transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore

1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, ose vetë nëpunësi civil, mund të kërkojë transferimin në një pozitë tjetër të së njëjtës kategori, ku është i aftë të kryejë detyrat.

1.1. Kërkesa me shkrim duhet të jetë e arsyetuar dhe të njëjtës i bashkëngjitet vërtetimi i gjendjes shëndetësore nga organi kompetent mjekësor, i siguruar sipas legjislacionit në fuqi dhe e njëjta i drejtohet NJMBNJ.

1.2. Nëpunësi civil dëgjohe nga NJMBNJ përpara se të marrë vendim dhe i paraqet asaj vërtetimin e gjendjes shëndetësore.

3. NJMBNJ merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe vendosë për transferimin e nëpunësit brenda KQZ, në një pozitë pune që i përshtatet gjendjes shëndetësore të konstatuar nga komisioni mjekësor.

Neni 12

Transferimi i përhershëm për shkak të shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit

1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, vet nëpunësi civil, ose NJMBNJ, mund të kërkojnë transferimin e përhershëm të nëpunësit civil, me qëllim shmangien e konfliktit të vazhdueshëm të interesit a të konflikteve të tjera të parashikuara në legjislacionin për konfliktin e interesit, në një pozitë tjetër të së njëjtës kategori ose me miratimin e nëpunësit, në një kategori më të ulët.

2. Nëpunësi civil që kërkon të transferohet, i paraqet NJMBNJ një kërkesë me shkrim dhe deklaron konfliktin e interesit. NJMBNJ njofton mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë për kërkesën e nëpunësit.

3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka të drejtë të kërkojë nga NJMBNJ transferimin e nëpunësit civil nëpërmjet një kërkesë të arsyetuar. Nëpunësi civil dëgjohe nga NJMBNJ, përpara se NJMBNJ të marrë vendim.

4. NJMBNJ merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni dhe vendos për transferimin e nëpunësit brenda KQZ, ose me marrëveshje, në një institucion tjetër ku ka të punësuar nëpunës civil.

Neni 13

Rastet e tjera të transferimit të përhershëm

1. Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 11 dhe 12 të kësaj Rregullore, nëpunësi civil mund të transferohet në mënyrë të përhershme, edhe në këto raste:

1.3. Pas përfundimit të pezullimit, me kërkesë të nëpunësit civil, kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 71 të LZP;

1.4. pas shqiptimit të transferimit si masë e pamjaftueshmërisë profesionale, në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 54 të LZP;

1.5. pas shqiptimit të transferimit si masë disiplinore, në pajtim me paragrafin 2.3 të nenit 57 të LZP.

Neni 14

Transferimi i përhershëm për interes të institucionit

1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme, në vend tjetër të punës, për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar.

2. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të KQZ, ose në institucion tjetër të shërbimit civil.

3. Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet.

4. Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë, bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, drejtorin e SKQZ dhe, me pëlqimin e nëpunësit civil që transferohet.

5. Transferimi i nëpunëses/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunëses/it dhe me marrëveshje në mes të KQZ dhe institucionit në të cilin transferohet nëpunësi civil.

6. Refuzimi për transferimin e përhershëm, mund të bëhet vetëm në këto raste:

6.1. Kur gjendja e saj/tij shëndetësore, e dëshmuar me vërtetim mjekësor, e pamundëson transferimin;

6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil;

6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin

Neni 15

Transferimi për shkak ristrukturimit të institucionit

1. Raste ristrukturimit të KQZ do të konsiderohen, ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat:
 - 1.1. Janë shkurtuar vende pune;
 - 1.2. janë ristrukturuar vende pune;
 - 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës.
2. Në rast se paraqiten rastet e përcaktuara si në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura, si pasojë e ristrukturimit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 66 të LZP.
3. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar, njoftohen individualisht nga NJMBNJ për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit, menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit të institucionit.

Neni 16

Komisioni i ristrukturimit

1. Në rastet e ristrukturimit, NJMBNJ brenda 15 dite pune nga miratimi i aktit të ristrukturimit, krijojnë një komision të ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori.
2. Komisioni udhëhiqet nga NJMBNJ dhe përbëhet edhe nga dy anëtarë tjerë, të cilët janë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nënparagrafin 2.1., 2.2. apo/dhe 2.4 të nenit 66 të LZP, sipas rastit.
3. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e themelimit, i propozon me shkrim NJMBNJ transferimin e nëpunësit civil, siç parashihet në nënparagrafin 2.1., 2.2. apo/dhe 2.4 të nenit 66 të LZP;
4. Komisioni, në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak ristrukturimit të institucionit, mbështetet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara, kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil.
5. Komisioni, gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret:
 - 5.1. Përvojën kohore të nëpunësit në shërbimin civil;

- 5.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit civil për 3 vitet e fundit;
 - 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit civil.
 - 5.4. trajnimet.
6. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter

Neni 17

Procedura e transferimit

1. NJMBNJ, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendosë për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
2. Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga NJMBNJ, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, në rastet e përcaktuara me paragrafin 6 të nenit 65 të LZP.
3. NJMBNJ verifikon shkaqet e refuzimit dhe mund të shfuqizojë vendimin, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 5 të nenit 66 të LZP.
4. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç atyre të përcaktuara paragrafin 5 të nenit 66 LZP, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.

Neni 18

Paga me rastin e transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit

1. Nëpunësi i transferuar në pozitën e të njëjtës kategori ku ka qenë, për shkak ristrukturimit të institucionit, e merr pagën e pozitës në klasën ku është transferuar.
2. Deri në momentit e përfundimit të procedurës së transferimit, sipas nenit 16 të kësaj Rregullore, nëpunësi civil merr pagën e njëjtë që e ka pasur para përfundimit të transferimit.

Neni 19

E drejta e ankesës

Në rast të pakënaqësive ndaj vendimeve për transfer sipas kësaj Rregullore, nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 20

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja nr. 04 / 2017 për avancimin në karrierë dhe transferimin e nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi